



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 5554 Prot.

Tiranë, më 30. 8. 2022

Lënda: Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2022-2023.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga “Aleksandër Moisiu” ✓
Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 100, datë 25.02.2022, “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar zhvillojnë procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Profili ku kandidati do të regjistrohet për të zhvilluar praktikën profesionale, duhet të lidhet me programin e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë që ka përfunduar kandidati.

Për vitin shkollor 2022-2023, aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesisë do të kryhet nëpërmjet platformës e-albania.

Kandidatët kanë të drejtë të zhvillojnë praktikën profesionale në një nga tri periudhat mësimore.

Afati i regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet platformës e-albania që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, në periudhën e parë mësimore është nga data 30.08.2022-07.09.2022, në periudhën e dytë mësimore është nga data 05.12.2022-15.12.2022 dhe në periudhën e tretë mësimore është nga data 06.03.2023-16.03.2023

Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, 7 ditë pas mbylljes së aplikimit të secilës periudhë, dërgojnë në DRAP-et përkatëse, listën e praktikantëve të periudhës përkatëse sipas tabelës bashkëlidhur shkresës.

Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, 7 ditë pas marrjes së listave nga ZVAP nën juridiksionin e tyre, hartojnë listat përfundimtare me kandidatët aplikantë të periudhës përkatëse në format Excel dhe i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar 7 ditë pas marrjes së listave nga DRAP, dërgon listat përfundimtare të kandidatëve të periudhës përkatëse, zyrtarisht me postë dhe në rrugë elektronike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, publikojnë në faqet zyrtare të internetit, listën e IAPP-ve, publike dhe/ose private, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale, në të tri fazat e aplikimit.

Praktikanti paraqitet në IAPP për të filluar praktikën profesionale në periudhën që ka aplikuar pas pranimit dhe lajmërimit nga ZVAP-të.

ZVAP-et të marrin masa, që përveç pikave të përkrahura në rregullore, praktikantët paraqesin edhe dokument banimi në rajonin e tyre si dhe fotokopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë dhe të dytë në fushën e edukimit. Praktikantët zhvillojnë praktikat profesionale në IAPP sipas emërimit në diplomën përkatëse.

ZVAP-të janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur si dhe për respektimin me rigozitet të kërkesave dhe të afateve të përcaktuara si më sipër.

Procesi i organizimit dhe zhvillimit të praktikës profesionale është objekt monitorimi nga MAS-ja, DPAP-ja dhe DRAP-të.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

